



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Komplast 1985 shpk" të datës 18.08.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "141 Ndërtimi i sistemit të ujitjes në hapësira gjelbëruese dhe hapja e puseve" me nr. të prokurimit 616-25-3717-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Komplast 1985 shpk" të datës 18.08.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "141 Ndërtimi i sistemit të ujitjes në hapësira gjelbëruese dhe hapja e puseve" me nr. të prokurimit 616-25-3717-5-1-1.
- II. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Komplast 1985 shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 18.08.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "141 Ndërtimi i sistemit të ujitjes në hapësira gjelbëruese dhe hapja e puseve" me nr. të prokurimit 616-25-3717-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

P.1.- "Autoritetit Kontraktues në mënyrë të kundërligjshme na ka eliminuar neve si Grup i Operatoreve: Komplast 1985 Shpk, Berisha Com Shpk & Komplast Sh.p.k. nga ky aktivitet i prokurimit pasi që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit dhe kemi ofruar oferten me cmim me te lire".

Fillimisht duhet sqaruar se parashtruesi është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për shkak të arsyeve të evidentuara si në vijim:

Ky GOE-ik nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe Dosje të tenderit në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 & 9.2, për pikën e kërkesës nr.4 .Kërkesa:Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit ; Aneksin 10 të DT Dëshmia e kërkuar dokumentare.

4. Një listë të mjeteve apo pajisjeve teknike që janë në dispozicionin tuaj për të ekzekutuar kontratën në fjalë- pajisjet dhe makineria në dispozicion duhet të dëshmohen me kopje të librezave mbi pronësinë e tyre ose DUD-i doganor. Në rast të marrjes me qera duhet të dëshmohet edhe me kontratë mbi qeramarrjen.

GOE-ik: për këtë pike të kërkesës me ofertën e tyre nuk ka dorëzuar listen e mjeteve dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit

- Me ofertë nuk ka dorëzuar sigurim të tenderit sipas kërkesës së DT-së.

-Kërkesa:Ju lutem ta plotësoni edhe ANEKSIN 7 sa i përket afatit të implementimit të projektit dhe periudhës garantuere, i cili aneks është pjesë e kësaj dosje dhe me ofertën e tyre nuk është plotësuar ky Aneks siq është kërkuar.

Parashtruesi pretendon që ka dorëzuar të gjitha dëshmitë dokumentare që janë kërkuar me DT dhe është eliminuar padrejtësisht. Ky fakt nuk qëndron sepse oferta e parashtruesit është dorëzuar përmes eprokurimit dhe të gjitha dokumentet që janë dorëzuar në këtë ofertë janë të regjistruara në platformën eprokurimi. Tutje në këtë ofertë të parashtruesi ekziston një folder i titulluar "sigurimi" dhe nëse hapet ky folder evidentohet vetëm një faqe A4 e zbrazët me ngjyrë të bardhë.

Në UPP pika 10 theksohet që në rastet kur mungon sigurimi i tenderit, oferta duhet të refuzohet pa kërkuar fare sqarime shtesë.

Sigurimi i Tenderit mungon apo nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	57
--	---	----

Pra vetëm për faktin që mungon sigurimi i tenderit, oferta e parashtruesit automatikisht duhet të eliminohet si e papërgjegjshme pavarësisht dokumenteve tjera në ofertë. Përndryshe edhe të gjeturat tjera të komisionit vlerësues, pasi që në ofertë nuk është dorëzuar fare aneksi 7 për implementimin e projektit, dëshmitë dokumentare lidhur me

pajisjet, si dhe dokumentet tjera sikurse janë evidentuar në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar – parashtruesit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 20.08.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.